



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Makroekonomisë përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Sektori Real

Nr.15, Shtator - Dhjetor 2013

Vlerësohet se ekonomia vendore përgjatë vitit 2013 u rrit me një shkallë prej rreth 3.2%, ngritje e cila është më e lartë prej rreth 0.8% nga rritja sa ishte shënuar përgjatë vitit 2012.


4.1% janë parashikimet fillestare për zgjerimin e aktivitetit ekonomik për vitin 2014, ku shtytës kryesor i kësaj rritje pritet të vije nga rritja e konsumit të përgjithshëm, kontributi i së cilës pritet të shënoj rreth 3.2%.

Për më shumë, investimet private pritet të kontribuojnë me rreth 1.8% në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2013.

Kontribut në rritje ekonomike pritet të vije nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve, shkalla e së cilës pritet të shënoj rreth 1.1%.

Përderisa, importet e mallrave pritet të ndikojnë negativisht me rreth -2.2% në rritje ekonomike.

Rritja vjetore e BPV -së , në përqindje (%)




Gjatë këtij tremujori, çmimet e përgjithshme matur nga Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) vazhduan trendin rënës të filluar nga fillimi i vitit. Në fund të tremujorit të tretë në mesatare çmimet e përgjithshme shënuan 1.5% ngritje.

Bazuar në raportimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), përgjatë këtij tremujori vërehet ngritje në çmimet e perimeve, bukës dhe drithërave.

Përderisa kjo ngritje u neutralizua nga rëniet në çmimet e pemëve dhe naftës.

Rrjedhimisht, në mesatare IÇK-ja gjatë vitit 2013 u ngrit për 1.7%. Bazuar në këto dhe informata shtesë, parashikohet se çmimet për vitin 2014 do të kenë një ngritje prej rreth 1.5% në raport me vitin 2013.

Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit, IÇK (në %)



Sektori i Jashtëm

Përgjatë tremujorit të katërt të vitit 2013, vlera e mallrave të eksportuara dhe mallrave të importuara shënuan ngritje në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Vlera e eksporteve të mallrave gjatë tremujorit të katërt shënoi rreth €66.9 milionë, vlerë e cila është më e lartë për rreth 4.1% në raport me tremujorin e katërt të vitit të kaluar.

Metalet bazë ishin produktet kryesore të eksportuara, pasuar nga produktet e mineraleve, produktet ushqimore, plastika dhe druri, makineritë dhe pajisjet elektrike.

Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtit sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e BE-së mbesin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.


Importet e mallrave vazhduan të ngriten. Tremujori i katërt shënoi 1.2% ngritje në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Deri në fund të periudhës raportuese (dhjetor, 2013) vlera e përgjithshme e mallrave të importuara arriti në €2.4 miliardë.

Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga ushqimi i përgatitur, pijet dhe duhani dhe pajisjet makinerike .

Si rezultat i rritjes më të ngadalshme të mallrave të importuara në raport me mallrat e eksportuara, bilanci negativ tregtarë u zvogëluar për rreth 1% gjatë këtij tremujori në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Importi , eksporti dhe bilanci tregtar, në miliona euro



Sektori Fiskal

Ecurit e të hyrave të përgjithshme buxhetore gjatë tremujorit të fundit të vitin ishin më të ngadalshme se sa përgjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Të hyrat e përgjithshme në fund të tremujorit të katërt të vitit shënuan rreth €348 milionë, shifër e cila është më e ulët për rreth 15% në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2012.


Rezultat i kësaj rënieje në të hyra ishte rënia në të hyrat nga Dogana, si burim kryesor i të hyrave të përgjithshme, të cilat shënuan €226.5 milionë, shifër e cila është më e ulët për rreth 7% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Tatimet vendore, të arkëtuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, shënuan një rënie të lehtë për rreth 1.9% në raport me vitin e kaluar duke shënuar vlerë prej rreth €79 milionë përgjatë tremujorit të fundit të vitit.

Përderisa shpenzimet e përgjithshme në fund të tremujorit të katërt të vitit shënuan ngritje prej rreth 4.4% për të arritur vlerën në €490.6 milionë.


Shpenzimet kapitale gjatë tremujorit të fundit të vitit ishin më të larta për rreth 7% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraprak.

Të hyrat buxhetore, në milione euro



Shpenzimet rrjedhëse ishin në nivel të njëjtë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, shpenzime të cilat shënuan rreth €180 milionë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në miliona euro



Sektori Financiar

Sektori bankar vazhdoj zgjerimin e tij edhe gjatë këtij tremujori. Asetet totale të sektorit bankar shënuan ngritje prej rreth 8% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, dhe ngritje prej rreth 4.2% në krahasim me tremujorin paraprak.

Depozitat në sektorin bankar në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan rreth 2.4 miliardë, shifër e cila është më e lartë për 7.5% në raport me tremujorin e katërt të vitit 2012.

Kreditë arritën vlerën prej €1.8 miliardë në fund të muajit dhjetor 2013, duke shënuar një ngritje vjetore prej 2.4% dhe 0.4% ngritje në raport me tremujorin paraprak.

Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve, energjetikës, industrisë dhe ndërtimitarisë dhe sektori i bujqësisë.

Norma mesatare e interesit në kredi përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 shënoj 12.63%, ndërsa norma mesatare e interesit në depozita shënoj 3.54%.

Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Tabela 1. Agregatet kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2013												Vjetore
	I			II			III			IV			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nen	Dhjet	
<i>€ miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndrysh</i>													
Rritja vjetore e BPV-së													3.2
Sektori Real													
IÇK (në %)	3.6	2.6	2.6	2.4	2.2	2.6	2.3	1.2	0.2	0.2	0.8	0.5	1.7
Projeksioni I IÇK-së (në %)													
Sektori i jashtëm													
Importi i Mallrave	139.7	156.4	195.3	205.8	213.7	222.4	229.7	228.2	210.4	218.8	206.1	223.9	2,450.4
Eksporti i Mallrave	21.5	22.7	23.1	27.8	27.3	26.4	27.1	23.2	24.9	26.2	21.8	21.9	293.9
Bilanci tregtar	-118.2	-133.7	-172.2	-178.0	-186.5	-196.0	-202.5	-204.9	-185.6	-192.6	-184.2	-202.1	(2,156.4)
Sektori Fiskal													
Të hyrat e përgjithshme	89.1	73.3	109.5	127.5	103.5	103.9	139.4	113.2	104.9	122.9	113.9	111.1	1,312.2
Të hyrat nga kufiri	44.2	45.9	57.1	71.1	73.1	70.5	90.1	82.2	76.5	77.7	67.0	81.8	837.2
Të hyrat vendore	33.5	19.8	19.2	37.8	18.8	18.7	35.9	22.6	20.1	35.7	20.8	22.5	305.4
Të hyrat jo tatimore	2.6	2.5	5.6	4.4	3.6	3.4	3.9	3.9	3.2	3.0	2.9	3.6	42.6
Te hyrat nga dividenda	0.0	0.0	20.0	10.0	0.0	0.0	3.0	0.0	0.0	0.0	10.0	0.0	43.0
Mbështetja buxhetore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.04	0.04	0.04	0.00	0.00	0.00	0.00	0.1
Shpenzimet e përgjithshme	38.0	137.1	104.8	109.9	140.4	81.9	131.6	150.0	84.1	143.2	167.5	179.9	1,468.4
Shpenzimet Rrjedhëse	29.9	84.2	78.0	80.9	108.2	36.2	75.1	97.8	39.1	87.9	113.4	108.5	939.2
Shpenzimet Kapitale	8.2	52.9	26.8	29.0	32.2	45.7	56.5	52.2	45.0	55.3	54.2	71.3	529.2
Remitancat			127.8			144.6			182.2				
Sektori Financiar													
Depozitat	2,265.1	2,278.3	2,269.4	2,231.4	2,247.0	2,201.3	2,271.2	2,370.9	2,344.7	2,354.6	2,359.2	2,449.0	2,449.0
Kreditë	1,754.9	1,765.6	1,782.7	1,801.6	1,810.0	1,825.7	1,816.0	1,790.1	1,798.0	1,798.8	1,803.2	1,805.8	1,805.8
MHN te korporatave financiare													

Burimi i të dhënave:

Sektorit Real dhe Sektori i Jashtëm: Enti i Statistikave të Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>

Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MF: <http://mf.rks-gov.net/>

Sektori Financiar: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>